

Rekomandimi CM/Rec(2025)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me promovimin e shëndetit mendor të të burgosurve dhe personave nën mbikëqyrje si dhe menaxhimin e çrregullimeve të tyre mendore

(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 26 shkurt 2025 në takimin e 1520-të të Zëvendësministrave)

Komiteti i Ministrave, në përputhje me nenin 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës (ETS nr. 1);

Duke pasur parasysh Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ETS nr. 5) dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Duke pasur parasysh Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor apo Poshtëruar (ETS nr. 126), punën e kryer nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor apo Poshtëruar (CPT) dhe në veçanti standardet e zhvilluara prej tij në Raportin e 3-të të Përgjithshëm mbi aktivitetet e CPT-së lidhur me shëndetin mendor të personave në ndalim;

Duke mbështetur theksin e fortë për qasje të barabartë në kujdesin shëndetësor të paraparë me Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Dinjitetit të Qenies Njerëzore në lidhje me Aplikimin e Biologjisë dhe Mjekësisë: Konventa për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë (ETS nr. 164);

Duke vënë në dukje rëndësinë specifike të parimit të barazisë në kujdes për personat me çrregullime mendore në institucionet ndëshkimore, të rikonfirmuar në nenin 35 të Rekomandimit të Komitetit të Ministrave Rec(2004)10 lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të personave me çrregullim mendor;

Duke u mbështetur në Rekomandimin Rec(2006)2-rev për Rregullat Evropiane të Burgjeve dhe në Rekomandimin Rec(98)7 lidhur me aspektet etike dhe organizative të kujdesit shëndetësor në burg, të cilët të dy parashikojnë dispozita të hollësishme për organizimin e kujdesit shëndetësor, përfshirë kujdesin shëndetësor mendor të të burgosurve;

Duke u mbështetur më tej në Rekomandimin CM/Rec(2010)1 mbi Rregullat e Këshillit të Evropës për Sprovim dhe në Rekomandimin CM/Rec(2017)3 mbi Rregullat Evropiane për sanksionet dhe masat në komunitet, të cilët të dy theksojnë detyrimin e shërbimeve të sprovimit për të respektuar të drejtat e njeriut të personave që i nënshtrohen sanksioneve dhe masave, dhe për të siguruar që, gjatë planifikimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve të tyre, të merret parasysh dinjiteti, shëndeti, siguria dhe mirëqenia e këtyre personave;

Duke theksuar Rekomandimin CM/Rec(2008)11 mbi Rregullat Evropiane për delinkuentët e mitur që i nënshtrohen sanksioneve ose masave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët nën moshën 18 vjeç;

Duke pasqyruar parimet udhëzuese dhe rekomandimet që burojnë nga gjetjet e Librit të Bardhë të Këshillit të Evropës lidhur me menaxhimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor nga shërbimet e burgjeve dhe të sprovimit (CM(2023)3-add);

Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

- të udhëzohen në legjislacionin, politikat dhe praktikën e tyre nga dispozitat e përfshira në aneksin e këtij rekomandimi;
- të sigurojnë që ky rekomandim dhe memorandum i shpjegues i tij të përkthehen dhe të shpërndahen sa më gjerësisht të jetë e mundur, dhe sidomos ndër autoritetet gjyqësore, stafin e burgjeve dhe të shërbimeve sprovuese, stafin e shëndetit mendor dhe vetë të burgosurit apo personat nën sprovim.

Shtojcë e Rekomandimit CM/Rec(2025)2

Pjesa I – Fushëveprimi dhe parimet e përgjithshme

Fushëveprimi

1. Ky rekomandim aplikohet për promovimin dhe mbrojtjen e shëndetit mendor, si dhe për menaxhimin e çrregullimeve mendore, të të burgosurve dhe personave nën sprovim nga autoritetet që sipas legjislacionit kombëtar kanë përgjegjësi për kujdesin shëndetësor, apo ndonjë aspekt të tillë të kujdesit, në lidhje me shëndetin mendor të të burgosurve dhe personave nën sprovë, pa marrë parasysh se cili institucion e ofron konkretisht këtë kujdes.
- 2.1. Ky rekomandim aplikohet për të rriturit që janë të burgosur ose nën sprovim.
- 2.2. Nëse, përjashtimisht, fëmijët nën moshën 18 vjeç mbahen në një burg për të rritur, ky rekomandim zbatohet për ta së bashku me çdo dispozitë tjetër të përcaktuar për të mbrojtur shëndetin mendor të fëmijëve në burg.
3. Për qëllimet e këtij rekomandimi, “të burgosur” janë personat e privuar nga liria për të cilët zbatohen Rregullat Evropiane për Burgjet (Rekomandimi Rec(2006)2-rev).
4. Për qëllimet e këtij rekomandimi, “persona nën sprovë” janë personat që i nënshtrohen shërbimit sprovues sipas përkufizimit në Rregullat Evropiane për Sprovim (Rekomandimi CM/Rec(2010)1).
5. Të burgosurit dhe personat nën sprovim me çrregullime mendore janë persona që kanë çrregullime serioze klinike në funksionimin kognitiv, rregullimin emocional apo sjelljen.

Parimet e përgjithshme

6. Të burgosurit dhe personat nën sprovim duhet të pranojnë pa vonesë mbështetjen dhe kujdesin që u nevojitet për të ruajtur, mbrojtur dhe përmirësuar shëndetin e tyre mendor, duke e respektuar dinjitetin e tyre njerëzor.
7. Kujdesi i shëndetit mendor duhet të marrë parasysh faktorët gjinorë dhe kulturorë që mund të përcaktojnë nevojat e të burgosurve dhe personave nën sprovim.
8. Të burgosurit dhe personat nën sprovim duhet të kenë qasje në kujdes shëndetësor mendor që prodhon rezultate të një cilësie të njëjtë me kujdesin shëndetësor mendor të ofruar për popullatën e përgjithshme.
9. Të burgosurve dhe personave nën sprovim duhet t’u ofrohet informacion përkatës, në formën që ata mund ta kuptojnë, mbi mënyrën se si mund të marrin mbështetje për shëndetin e tyre mendor.
10. Duhet të merren masa alternative për të burgosurit dhe personat nën sprovim, shëndeti mendor i të cilëve është i papërshtatshëm me dënimin ose masën e vendosur.
- 11.1. Kur shëndeti mendor i një të burgosuri e bën të domosdoshme ndarjen e tij nga të burgosurit e tjerë, kjo ndarje mund të zbatohet derisa të plotësohen kërkesat nga Rregulli 53A i Rregullave Evropiane për Burgjet.
- 11.2. Izolimi si masë ndëshkimore disiplinore nuk duhet të vendoset ndaj një të burgosuri me çrregullim mendor, përveç nëse plotësohen kërkesat nga Rregulli 60.6.b i Rregullave Evropiane për Burgjet.
- 11.3. Një i burgosur nuk duhet të izolohet kurrë vetëm për shkak të shëndetit të tij mendor.

12. Kur shërbimet për kujdesin e shëndetit mendor për të burgosurit dhe personat nën sprovim ofrohen nga autoritete të ndryshme, këto autoritete duhet të bashkëpunojnë ngushtë dhe të marrin përgjegjësi bashkë për këto shërbime, duke siguruar që ky bashkëpunim është në përputhje me të gjitha standardet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin mjekësor.

13. Duhet të sigurohet vazhdimësia e kujdesit për shëndetin mendor për të burgosurit dhe personat nën sprovim, në lidhje me kujdesin e nisur para ose gjatë periudhës së burgimit apo sprovimit të tyre.

14. Kur të burgosurit ose personat nën sprovim i nënshtrohen ndërhyrjeve që lidhen me veprën penale për të cilën janë dënuar, ato ndërhyrje duhet të jenë në përputhje me promovimin e shëndetit të tyre të përgjithshëm mendor.

Pjesa II – Promovimi dhe mbrojtja e shëndetit mendor

Promovimi i shëndetit mendor

15.1. Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit mendor i të burgosurve dhe personave nën sprovim duhet të promovohet përmes inkurajimit të të burgosurve, personave nën sprovim dhe stafit përkatës për të nxitur shëndetin e mirë mendor.

15.2. Shëndeti i mirë mendor duhet të nxitet përmes:

- a. krijimit të një mjedisi mbështetës dhe me përkujdesje;
- b. ofrimit të informacioneve dhe edukimit mbi shëndetin mendor;
- c. sigurimit të qasjes në shërbimet e shëndetit mendor që nga pranimi në burg apo vendosja nën sprovim;
- d. njohjes dhe, kur është e mundur, adresimit të përcaktuesve shoqërorë të shëndetit mendor;
- e. ofrimit të qasjes dhe krijimit të mundësive për aktivitete fizike, arte kreative dhe programe të tjera që promovojnë mirëqenien;
- f. mbështetjes së kontakteve prosociale dhe me komunitetin; dhe
- g. ofrimit të mbështetjes për riintegrimin në komunitet.

Mbrojtja e shëndeti mendor

16.1. Autoritetet që merren me të burgosurit dhe personat nën sprovim duhet të jenë të ndjeshme ndaj nevojave të atyre personave, shëndeti mendor i të cilëve mund të kërkojë masa specifike mbrojtëse.

16.2. Kur është e nevojshme, këto autoritete duhet të marrin masa për të mbrojtur shëndetin mendor të të burgosurve dhe personave nën sprovim përmes:

- a. adresimit të abuzimit me substanca;
- b. sigurimit të qasjes në shërbime për ndërhyrje gjatë krizës; dhe
- c. trajtimit të çështjeve sistemike brenda sistemit shëndetësor dhe të drejtës penale që kontribuojnë në rezultate të dobëta për shëndetin mendor.

Parandalimi i vetëlëndimit dhe vetëvrasjes

17. Autoritetet që merren me të burgosurit dhe personat nën sprovim duhet të marrin masa të veçanta për të parandaluar vetëlëndimin dhe vetëvrasjen përmes:

- a. zhvillimit dhe zbatimit të politikave që adresojnë në mënyrë specifike vetëlëndimin dhe parandalimin e vetëvrasjes;
- b. identifikimit të rreziqeve për vetëlëndim dhe vetëvrasje;

- c. ofrimit të qasjes në këshillim të shpejtë dhe efektiv, si dhe forma të tjera mbështetjeje, për të burgosurit dhe personat nën sprovim që janë në rrezik për vetëlëndim dhe vetëvrasje;
- d. vendosjes së protokolleve të qarta për reagimin ndaj vetëlëndimit dhe përpjekjeve për vetëvrasje, përfshirë ndërhyrjen urgjente mjekësore dhe psikologjike;
- e. krijimit të njësive të specializuara ose dhomave të sigurta, në rastin e burgjeve, për të burgosurit në krizë akute, duke siguruar mbikëqyrjen dhe mbështetjen e tyre; dhe
- f. rishikimit dhe përditësimit të rregullt të politikave bazuar në praktikën më të mira dhe hulumtimet më të reja mbi vetëlëndimin dhe vetëvrasjen.

Pjesa III – Menaxhimi i çrregullimeve mendore

Vlerësimi

18.1. Meqë të burgosurit dhe personat nën sprovim me çrregullime mendore kërkojnë trajtim specifik dhe të menjëhershëm, si dhe ndërhyrje të tjera, autoritetet përgjegjëse duhet të sigurojnë që të burgosurit dhe personat nën kujdesin e tyre të vlerësohen nga stafi i kualifikuar përkatës ose nga shërbime të jashtme të shëndetit mendor për të identifikuar personat me çrregullime mendore.

18.2. Vlerësimi duhet të përfshijë vlerësimin mbi përdorimin e substancave dhe të problemeve mjekësore dhe shoqërore të ndërlidhura.

18.3. Vlerësimi duhet:

- a. të kryhet me rastin e pranimit në burg në rastin e të burgosurve;
- b. të kryhet para liritë nga burgu ose në fillim të periudhës së sprovimit në rastin e personave që nuk referohen në shërbimin sprovues drejtpërdrejt nga burgu; dhe
- c. të përsëritet kur është e nevojshme.

Vlerësimi

19. Nëse pas vlerësimit konstatohet se të burgosurit ose personat nën sprovim kanë shenja të një çrregullimi mendor, atyre duhet t'u ofrohet një vlerësim gjithëpërfshirës për të konfirmuar nëse gjetja fillestare ishte e saktë dhe për të përcaktuar natyrën dhe seriozitetin e çrregullimit të tyre mendor, si dhe çdo rrezik që mund të paraqesin ose nevojë që mund të kenë.

Trajtimi i çrregullimeve mendore

20.1. Shërbimet e burgut dhe të sprovimit duhet të lehtësojnë qasjen e të burgosurve dhe personave nën sprovim në një seri trajtimesh efektive për shëndetin mendor.

20.2. Trajtimi i çrregullimeve mendore duhet të ofrohet nga staf i specializuar ose përmes shërbimeve të përgjithshme të shëndetit mendor, duke përfshirë, sa më shumë që të jetë e mundur, një qasje ndërdisiplinore.

20.3. Trajtimi i çrregullimeve mendore duhet të bazohet në pëlqimin e lirë dhe të informuar të të burgosurve dhe personave nën sprovim, përveç kur një trajtim i tillë mund të aplikohet pa pëlqimin e tyre për arsye mjekësore të përcaktuara në legjislacionin vendor.

20.4. Trajtimi i të burgosurve dhe personave nën sprovim me çrregullime të lidhura me abuzimin me substanca duhet, nëse është e nevojshme, të përfshijë trajtim zëvendësues dhe metoda të tjera për reduktimin e dëmit.

Ndërhyrja në krizë

21.1. Një krizë e shëndetit mendor duhet të trajtohet, sa më shumë që të jetë e mundur, nga një perspektivë terapeutike, nën mbikëqyrjen e stafit shëndetësor.

21.2. Në rast se një i burgosur përjeton një krizë të shëndetit mendor:

- a. agjencitë që ndërhyjnë në një krizë të tillë duhet të vlerësojnë situatën nga ana mjekësore dhe të ofrojnë mbështetje, ndihmë dhe trajtim të menjëhershëm, qoftë nga shërbimi shëndetësor i burgut apo përmes referimit tek një shërbim i jashtëm i shëndetit mendor;
- b. çdo ndërhyrje në krizë duhet të jetë sa më pak ndërhyrëse që të jetë e mundur;
- c. ndarja e të burgosurit nga të tjerët apo përdorimi i forcës ose i kufizimeve fizike si pjesë e ndërhyrjes në krizë duhet të shmanget sa herë që është e mundur, pasi këto masa mund ta përkeqësojnë gjendjen e të burgosurit; dhe
- d. nëse ndarja apo përdorimi i forcës ose i kufizimeve fizike nuk mund të shmanget si pjesë e ndërhyrjes në krizë, atëherë zbatohen kufizimet dhe kushtet e përcaktuara në Rregullat Evropiane për Burgjet.

21.3. Në rast se një person nën sprovim përjeton një krizë të shëndetit mendor e cila bëhet e njohur për shërbimet sprovuese, ato duhet të ndërhyjnë duke e referuar atë në shërbimin përkatës të shëndetit mendor në komunitet.

Pjesa IV – Stafi

Shëndeti mendor

22. Autoritetet që punësojnë staf, detyrat e të cilit përfshijnë promovimin dhe mbrojtjen e shëndetit mendor, si dhe menaxhimin e çrregullimeve mendore të të burgosurve dhe personave nën sprovim, duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për ta mbështetur këtë staf në përballimin e stresit të lidhur me realizimin e këtyre detyrave.

Trajnimi

23.1. Stafi i burgjeve dhe i shërbimeve sprovuese duhet të marrë trajnim mbi promovimin dhe mbrojtjen e shëndetit mendor si dhe menaxhimin e çrregullimeve mendore.

23.2. Ky trajnim duhet t'i aftësojë ata të ndërveprojnë në mënyrë efektive me të burgosurit dhe personat nën sprovim që kanë çrregullime mendore, të përmirësojnë cilësinë e kujdesit dhe të reduktojnë rrezikun e pasojave negative.

23.3. Ky trajnim duhet gjithashtu t'i ndihmojë anëtarët e stafit të përballen me stresin mendor të lidhur me punën.

Pjesa V – Informacioni dhe hulumtimi

Informacioni

24.1. Të dhëna të qasshme, të anonimizuara dhe të grumbulluara mbi përhapjen e çrregullimeve mendore në sistemin penal duhet të mblidhen në mënyrë sistematike, me qëllim të planifikimit efektiv të shërbimeve dhe lehtësimit të hulumtimeve për përmirësimin e kujdesit.

24.2. Të dhënat e anonimizuara mbi vetëvrasjet, përpjekjet për vetëvrasje dhe vetëlëndimet, kur janë të qasshme, duhet të mblidhen dhe monitorohen rregullisht.

Hulumtimi

25. Hulumtimi duhet të financohet mjaftueshëm dhe të realizohet për të zhvilluar një bazë të përmirësuar të dëshmive mbi ndërhyrjet efektive që mbështesin të burgosurit dhe personat nën sprovim me çrregullime mendore, si dhe për të punuar drejt zbatimit të politikave dhe praktikave për shëndetin mendor në sistemin penal.